

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **MMPAU** me objekt: “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko financiare dhe vlerësues, për periudhën 1/10/2009 deri me 31/12/2011*” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 94, datë 27/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 163/7, datë 27/06/2012 dërguar **Z. Fatmir Mediu, Ministër i MMPAU**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Nga auditimi është konstatuar se ndërmarrjet e ujësjellësëve sh.a. nuk kanë zbatuar vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 9/1/2008 “*Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit*”, pikën 2. Megjithëse aktiviteti i tyre është subvencionuar nga shteti, dhe vetë vlera e tarifës së ujit është element përbërës i kostos së llogaritur, si për subvencion dhe në çmimin e shitjes së ujit të përdorur për konsumatorët. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të bashkëpunohet me Ministrinë e Financave dhe të hartohet një Udhëzim i Përbashkët, ku të përcaktohen qartë detyrimet e secilës palë, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 8093, datë 21/3/1996 “Për rezervat ujore” i ndryshuar, VKM nr. 23, datë 12/11/2008, “Për tarifën e përdorimit të ujit”, i ndryshuar me VKM nr. 1484, datë 12/11/2008 nga NKU sh.a. dhe bashkive e komunave për të vendosur varësinë e pagesës së tarifës së ujit në buxhetin e shtetit, si e ardhur e rëndësishme në buxhet (nëpërmjet AUB-ve), për financimin me Grante e fonde për investime.

Brenda muajit Shtator 2012

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Në auditimin e kryer mbi parashikimin, llogaritjen, dokumentimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore (kryesore) që krijohen nga aktiviteti që kryhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Administrimit të Ujërave dhe në 6 Agjencitë Ujëmbledhëse të Baseneve (AUB), ka rezultuar se për periudhën e audituar 2010-2011 nuk ka patur parashikim të ardhurash, si nga shërbimet dhe nga arkëtimi i pagesës së tarifës së ujit nga perdoruesit e tyre (Ndërmarrjet e Ujësjellës

Kanalizime sh.a., Bashki e Komuna dhe subjekte të tjera private etj.) si dhe të ardhurat nga mungesa e administrimit dhe mos ndjekjes së arkëtimit të tyre, ku ato kanë pësuar ulje në këto dy vite. Janë konstatuar mungesa dokumentimi dhe përdorim dokumentesh jo në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për këtë, **rekomandojmë që:**

a) Nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) dhe përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Agjensitë Ujëmbledhëse të Baseneve (AUB), të analizohet situata e krijuar duke patur parasysh konstatimet dhe mangësitë e trajtuara nga Auditimi i kryer nga KLSH për periudhën e mbetur të vitit 2012 të hartohet planifikimi i të ardhurave që do të realizohen nga AUB e të kërkohet realizimi i tij.

Menjëherë

b) Të ngrihet grup pune dhe të hartohen fatura tip në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duke unifikuar dhe miratuar faturën tip të pagesës së tarifës së përdorimit të ujit si për subjekte shtetërore dhe private.

Brenda muajit Korrik 2012

2. Nga auditimi i kryer nga AUB (Basene) në juridiksion të MMPAU, janë konstatuar mangësi në zbatimin e rregullave të caktuara në dokumentimin, kontabilizimin dhe ndjekjen e arkëtimit të debitorëve dhe regjistrimin e veprimeve ekonomike e financiare që kryhen në këto AUB,(deri në mos kontabilizim , si në AUB Ishëm Erzen,Tiranë). Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Të analizohen problemet e ngritura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të përcaktohen e merren masa organizative dhe të nxirret përgjegjësia për gjendjen e krijuar dhe të rishikohen organikat e AUB (Basen), ku të vendosen detyrimisht ekonomistë për kryejen e veprimeve ekonomike, si në Basenin e Ishëm Erzen, Tiranë, AUB Elbasan, etj, Gjithashtu të kërkohet që të zbatohen standardet e caktuara me ligj për veprimet ekonomiko financiare, duke mbajtur dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

Brenda muajit Korrik 2012

3. Nga auditimi i kryer në AUB (Basene) u konstatua se organizimi i punës në bazene, kryesisht për aktivitetin ekonomiko-financiar, ku bëjnë pjesë dhe të ardhurat, ka qenë jo efektiv dhe jo profesional, me pasojë mosmenaxhim të detyrës së ngarkuar dhe mungesë monitorimi e drejtimi nga sektori përkatës (tani riorganizuar në Drejtori të Përgjithshme) në MMPAU, duke i shkaktuar **buxhetit të shtetit një mungesë të ardhurash në vlerë 28.560 mijë lekë, të pa paguara e të pa arkëtuara nga 49 ndërmarje e Shoqëri anonime Ujësjellës-**

Kanalizimeve. Kjo mungesë i përket periudhës së vitit 2010 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2011, konkretisht :

1. Agjencia e Basenit Tiranë	6 subjekte	në vlerën	14,173 mijë lekë;
2. Agjencia e Basenit Vlorë	11 subjekte	“	5,586 mijë lekë;
3. Agjencia e Basenit Shkodër	11 subjekte	“	5,241 mijë lekë;
4. Agjencia e Basenit Fier	5 subjekte	“	1,454 mijë lekë;
5. Agjencia e Basenit Elbasan	9 subjekte	“	1,326 mijë lekë;
6. Agjencia e Basenit Lezhë (Mat)	7 subjekte	“	780 mijë lekë;
Totali:	49 subjekte	“	<u>28,560 mijë lekë.</u>

Përsa më sipër, **rekomandojmë që:**

a) Të analizohet me përgjegjësi situata e detyrimeve dhe të nxirren përgjegjësitë e personave shkaktarë, që do të bëhet plan masash i detajuar për kërkesën dhe arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke përcaktuar hapat dhe afatet konkretë.

b) Të bashkëpunohet me Prefektët e Qarkut sipas juridiksionit të ndërmarrjeve të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a. me bashkitë dhe komunat, për të bërë të mundur arkëtimin e këtyre detyrimeve në buxhetin e shtetit, duke e përcaktuar atë si detyrim ligjor të pagesës së tarifës ujit, si pjesë e pasurisë kombëtare.

c) Nga Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizimeve (me shkresë zyrtare ose nga Web-site i saj), të merren masa, të bëhen llogaritjet dhe të evidentohen detyrimet e pagesave mbi treguesit e konsumit të ujit për çdo institucion **për 6 mujorin e dytë të vitit 2011**, (të pa llogaritur nga grupi i audituesve të KLSH,pasi nukishin abdetuar të dhënat nga DPUK) si dhe të bëhen rakordimet nga AUB-të sipas përkatësisë së juridiksionit të NKU sh.a.

Brenda muajit Korrik 2012

4. Nga auditimi i kryer, konstatohet se me ndryshimet e ndodhura në lidhje me kalimin e ndërmarrjeve të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a. në varësi të bashkive dhe krijimin e sektorëve dhe ndërmarrjeve të reja nga Bashkitë e komunat, ka mungesë bashkëpunimi dhe mos përmbushje të detyrimit ligjor për vendosjen e rregullave të caktuara në lidhje me përdorimin e burimeve ujore si për ujë të pijshëm, teknologjik dhe industrial. Kjo të mbështetet në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 4365/1 prot, datë 14/1/2009 me Ministrinë Punëve Publike dhe Transporti, nr 8450/2 prot. datë 20/1/2009 (që kishte në varësi direkte këto ndërmarrje, megjithëse kjo nuk ka gjetur zbatim të plotë). Për këtë, **rekomandojmë që:**

a) Nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të ngrihet një grup pune në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit dhe të hartohet një Udhëzim i Përbashkët ku të

përcaktohen qartë detyrimet e secilës palë në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 8093, datë 21/3/1996 “Për rezervat ujore” i ndryshuar, VKM nr. 23, datë 12/11/2008, “Për tarifën e përdorimit të ujit”, i ndryshuar me VKM nr. 1484, datë 12/11/2008.

b) Të ndiqen të gjithë hapat ligjor deri në ngritjen e një task force të përbashkët ku dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve të jetë pjesë, për të detyruar përdoruesit e ujit (ndërmarrjet UK sh.a., Bashkitë e komunat) që të nënshkruajnë kontratat e përbashkëta me AUB (Basenet) sipas juridiksionit dhe të kërkohet vendosja e matësve për të gjithë përdoruesit e ujit (si me rrjedhje dhe me ngritje mekanike).

Brenda muajit Shtator 2012

5. Nga auditimi i kryer rezulton se në AUB (Basene) mungojnë të dhëna e tregues të konsumit të ujit të pijshëm e industrial si nga komunat dhe bashkitë të cilët marrin ujë me shpime ose ngritje mekanike, si dhe mungon informacioni për llogaritjet e detyrimeve për pagesë tarife të përdorimit të ujit. Në këto subjekte nuk janë vendosur kontator në daljen e ujit në asnjë nga Bashkitë dhe komunat, kjo për të gjitha basenet e ujit, si dhe mungon administrimi i treguesve që sjellin llogaritjen e pagesës. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Nga MMPAU, në bashkëpunim me Prefektët e qarkut (sqarojmë se Prefekti i Qarkut është kryetar i UB) dhe AUB, të evidentojnë të gjitha Bashkitë e Komunat që përdorin ujë dhe të bëjnë llogaritjet sipas normave të konsumit për banor, në mungesë të matësit (Kontatorit) dhe të kërkohet nga të gjitha komunat e bashkitë që kanë këto basene që të paguhet detyrimi i llogaritjes, në varësi të normave të konsumit dhe numrit të banorëve.

Brenda muajit Tetor 2012

6. Në auditimin e kryer mbi hartimin e dokumentacionit të kontrollit dhe inspektimeve që kryhen në subjektet e ndryshme, është konstatuar se procedura e ndjekur nga AUB Erzen-Ishëm. Ky fenomen është dhe në 5 AUB-të e tjera), është jo konform kërkesave ligjore në fuqi, pasi janë mbajtur 81 procesverbale “Mbi konstatimin e kundravajtjeve” dhe ato janë përcjellë Inspektoriatit Ndërtimor, Urbanistik Kombëtar (INUK), por deri më kohën e auditimit nuk ka asnjë përgjigje. Këto procesverbale konstatimi nuk kanë ndjekur procedurën ligjore si kundravajtjet administrative dhe nuk kanë asnjë vendim të Këshillit të Basenit të Ujit, që ti shoqërojë ato gjë që bie Kjo është në kundërshtim me Ligjin nr. 8093, datë 21/3/1996 “Për rezervat Ujore”, i ndryshuar me ligjin nr. 8605, datë 20/4/2000, në nenin 69.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

a) Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujit, në bashkëpunim me INUK, të propozojë do kërkojnë që Ministri të nxjerrë një urdhër, ku të përcaktohen qartë procedurat që duhen ndjekur (në çdo rast procesverbalet të shoqërohen me Vendime të Këshillit të Basenit që kryesohet nga Prefekti i Qarkut.

b) Të hartohet program pune dhe të kërkohet bashkëpunimi me MPPT INUK e Prefektët e Qarkut, (Prefekti i Qarkut është kryetar i Këshillit të Basenit), për ekzekutimin e procesverbaleve të konstatimit dhe zbatimin e procedurave ligjore në fuqi nga hallkat që detyrohen nga ligji.

Menjëherë

7. Nga auditimi i kryer për administrimin e **ujërave termale** që ndodhen në basenet Shkumbin, Elbasan dhe Drin-Bunë, Shkodër është konstatuar se nuk ka asnjë llogaritje apo pagesë nga subjektet private që përdorin këto ujëra në kundërshtim me VKM nr.23, datë 9.01.2008, i ndryshuar, në tabelën “Tarifat e përdorimit të ujit”, pika 3 “Banjat Termale”, pika 3.1.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Nga MMPAU në bashkëpunim me Prefektin e Qarkut të zonave përkatëse dhe Drejtoritë Rajonale të Tatim Taksave në këto rrethe, të merren hapat e duhura ligjore për llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimit ligjor nga subjektet private që përdorin ujin termal për qëllime fitimprurëse. Për këtë, të përdoren mënyra alternative që nga këto subjekte (hotele e persona fizik) me kontrata periodike me subjektet, mbështetur në Ligjin nr. 8093, datë 21/3/1996 “Për rezervat Ujore”, i ndryshuar, neni 25/1 dhe 36/1 dhe Ligjin nr.10081, datë 23/2/2009 “për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të arkëtohet tarifa e ujit që përdorin për shërbime ndaj klientëve. Llogaritja e tyre në mungesë të sahatëve matës, të bëhet nga specialisti me metoda bashkëkohore, sipas burimeve apo rrjedhjeve ujore që përdoren.

Brenda muajit Gusht 2012

8. Nga auditimi i i dokumentacionit të Këshillave të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin Elbasan, Tiranë, etj rezulton se nuk është realizuar numri minimal vjetor i mbledhjeve (minimumi një mbledhje në tre muaj, pra 4 mbledhje në vit), e cila është në kundërshtim me VKM nr.3, datë 19/7/2002 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshillit të Basenit Ujëmbledhës dhe Agjencisë së Ujit” i ndryshuar.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Të merren masa nga MMPAU për zbatimin e VKM nr. 3, datë 19/7/2002 dhe të përgatiten materiale përgjithëse, duke njoftuar Kryeministrin për ata Prefekt Qarku që nuk përmbushin detyrimin si Kryetar të Këshillit të Baseneve përkatëse.

Vazhdimisht

9. Nga auditimi i kryer për evidentimin, dokumentimin, rakordimin dhe arkëtimin e detyrimeve debitore në 6 AUB, rezultoi se gjëndja e ulët e arkëtimit të detyrimeve debitore ka ardhur nga mosfunksionimi i degës apo sektorit të financës si pasojë e moszbatimit të Ligjit nr.9228, date 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- MMPAU, të studiojë dhe të bëjë organizimin, funksionimin e 6 Agjencive Ujore të Baseneve, sipas Ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, duke ndryshuar strukturën aktuale të tyre dhe përfshirjen në të dhe të specialistëve ekonomistë.

Menjëherë

10. MMPAU, të marrë masa që të përfundojë hartimin e Rregullores të Brendshme, duke ju përshtatur strukturës dhe organikës aktuale.

Menjëherë

11. MMPAU, të marrë masa dhe të përcaktojë brenda strukturës aktuale të saj koordinatoren e riskut, sipas kërkesës së nenit 10, të Ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

12. Të meren masa dhe të bëhet evidentimi i saktë dhe rakordimi i të gjitha detyrimeve për shfrytëzim uji nga subjektet e ndryshme private nga 6 Agjencitë e Ujit të Baseneve me Drejtorinë e Politikave të Ujrave dhe Sektorin e Buxhetit në MMPAU, ndërkohë për subjektet që nuk shlyejnë detyrimet ti propozohet KBU nga AUB heqja e lejeve për shfytëzim uji.

Menjëherë

13. Nga auditimi i kryer në 4 AUB u konstatua se nuk bëhej matja e sasisë së ujit që përdorin subjektet e ndryshme private për larjen e inerteve, duke ndikuar drejtpërdrejtë në realizimin e të ardhurave të AUB-ve dhe krijimin e kushteve për shpërdorimin e ujit.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Të kërkohet në një afat sa më të shkurtër, vendosja e matësave të ujit, nga subjektet që shfrytëzojnë shtretërit e lumenjve për nxjerrjen e inerteve dhe që përdorin ujin për larjen e tyre. Kjo do të bëjë të mundur llogaritjen ekzakte të detyrimeve që kanë këto subjekte që përdorin ujin për larjen e inerteve, problem i trajtuar edhe në kontrollet e mëparshme.

Brenda muajit Dhjetor 2012

14. Të ndiqen me rigorozitet procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik nga dy subjekte, detyrë kjo e lënë në auditimin e mëparshëm, konkretisht:

a) Shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 60,000 lekë, nga “Instituti i Fizikës Bërthamore”.

b) Shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 140,000 lekë, nga subjekti “Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore” (Departamenti i Tokës dhe Ujit) Fushë Krujë.

Brenda muajit Tetor 2012

15. Të vazhdojë ndjekja dhe arkëtimi i detyrimeve debitore nga viti 2001 në shumën **2,024,622 lekë** nga ana e institucionit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, detyrë kjo e lënë nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Menjëherë

16. Të vazhdojë ndjekja e zbatimit të detyrave në proces realizimi ose pjesërisht të porealizuara, konkretisht:

a) Nga MMPAU, Drejtoria e Politikave të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe, të hartohet plani i veprimit për mbarështrimin në nivel kombëtar, rajonal e vendor për zhvillimin dhe menaxhimin e integruar të kullotave dhe livadheve, në ruajtjen e mjedisit, të ekuilibrit biologjik dhe biodiversitetit në fondin kullosor.

b) Nga MMPAU, Drejtoria e Politikave të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, të merren masa për sistemimin e diferencave të konstatuara në administrimin e fondit kullosor shtetëror, komunar e privat të evidentuara në rregjistrat e kadastrës DSHP-ve me gjëndjen e administruar në rregjistrin e kadastrës së DPPK-së.

c) Të merren masa nga MMPAU për zbatimin e rregullave në shfrytëzimin e inerteve të shtretërve të lumenjve dhe përrenjve të Tiranës, në afërsi të urave dhe argjinaturave në basenet e lumenjve të tjerë, dhe jashtë periudhës 1 qershor-31 tetor.

d) MMPAU në bashkëpunim me D.SH.P Sarandë, Inspektoriatin e Ndërtimit dhe Komunën Xarë, të kërkojë prishjen e ndërtimeve në Kepin e Stillos, pasi janë bërë në kundërshtim me nenin 19, të ligjit nr. 8906, datë 6/6/2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8405, datë 17/9/1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

Brenda muajit Dhjetor 2012

17. Të merren masa organizative, për të saktësuar llogaritjet e detyrimeve debitore dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar nga *6 AUB (të listuar më*

poshtë me vlerat përkatëse) shpërblimin e detyrimeve debitore në vlerën prej 104,327,730 lekë, vlerë kjo që përfaqëson detyrime nga përdorimi i ujit nga subjekte të ndryshme.

- AUB Ishëm Erzen	9,614,352 lekë;
- AUB Fier	37,401,488 lekë;
- AUB Vlorë	16,987,865 lekë;
- AUB Shkodër	4,843,696 lekë;
- AUB Elbasan	3,717,025 lekë;
- AUB Lezhë	1,763,124 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2012

18. Të merren masa organizative, për të saktësuar llogaritjet e detyrimeve debitore dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore, për të kërkuar nga AUB Fier që për subjektin [REDAKTUAR], i cili është debitor në shumën 3,720,177 lekë nga viti 2008, të arkëtohet kjo vlerë në të kundërt t'i hiqet leja e përdorimit të ujit nga KBU Seman.

Brenda muajit Shtator 2012

D. MASA DISIPLINORE

D.1 *Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13/6/2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, gërma a, për:

1. [REDAKTUAR] *ish Sekretare e Përgjithshme* (Të dërgohet masa në Departamentin e Administratës Publike) në cilësinë e Kryetares së komisionit të vlerësimit të ofertave, sepse;

- ka lejuar kualifikimin e ofertave në kushtet e mosplotësimit të dokumentacionit dhe kriterit teknik të kualifikimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 46, germa b të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 me ndryshimet, shkelje e konstatuar në tenderin me objekt “Blerje autoveturë e përdorur”, me fond limit rreth 2,375 mijë lekë, zhvilluar më 30/7/2010; në tenderin me objekt “Shërbimi i ruajtjes së MMPAU-s”, me fond limit 2,021,000 lekë (Pa t.v.sh.), zhvilluar më 15/2/2010.

2. [REDAKTUAR] *me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës*, në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave dhe njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, sepse:

- ka lejuar kualifikimin e ofertave në kushtet e mosplotësimit të dokumentacionit dhe kriterit teknik të kualifikimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 46, germa b të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 me ndryshimet, shkelje e konstatuar në

tenderin me objekt “Blerje autoveturë e përdorur”, me fond limit rreth 2,375 mijë lekë, zhvilluar më 30/7/2010;

- ka lejuar shkelje të rregullave në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, duke mos zbatuar detyrat e përcaktuara në Kreun V, pika 2, gërma “a” të VKM nr.1, date 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, shkelje e konstatuar në tenderin me objekt “**Shërbimi i ruajtjes së MMPAU-s**”, me vlerë 2,021,000 lekë, zhvilluar më 15/2/2010.

3. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Prokurimeve, në cilësinë e Kryetarit të Njesisë të hartimit të dokumenteve të tenderit, sepse:

- nuk ka zbatuar rregullat për vlerësimin e përcaktimin e drejtë të dokumentacionit për firmat e ftuara në negociim lidhur me kërkesat specifike për kualifikim, kjo është në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 me ndryshimet dhe me Dokumentet Standarde të Tenderit. Kjo parregullsi është konstatuar në tenderin me objekt “Blerje autoveturë e përdorur”, me fond limit rreth 2,375 mijë lekë, zhvilluar më 30/7/2010.

4. [REDAKTUAR] Specialist në Sektorin e Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njesisë të hartimit të dokumenteve të tenderit, sepse:

- nuk ka zbatuar rregullat për vlerësimin e përcaktimin e drejtë të dokumentacionit për firmat e ftuara në negociim lidhur me kërkesat specifike për kualifikim, kjo është në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 9643, date 20/11/2006 me ndryshimet dhe me Dokumentet Standarde të Tenderit. Kjo parregullsi është konstatuar në tenderin me objekt “Blerje autoveturë e përdorur”, me fond limit rreth 2,375 mijë lekë, zhvilluar më 30/7/2010.

5. [REDAKTUAR] me detyrë Specialiste në Sektorin e Prokurimeve, në cilësinë e anëtares së Njesisë të hartimit të dokumenteve të tenderit, sepse:

- nuk ka zbatuar rregullat për vlerësimin e përcaktimin e drejtë të dokumentacionit për firmat e ftuara në negociim lidhur me kërkesat specifike për kualifikim, kjo është në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 9643, date 20/11/2006 me ndryshimet dhe me Dokumentet Standarde të Tenderit. Kjo parregullsi është konstatuar në tenderin me objekt “Blerje autoveturë e përdorur”, me fond limit rreth 2,375 mijë lekë, zhvilluar më 30/7/2010.

6. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme, në cilësinë e Kryetarit të njesisë të hartimit të dokumenteve të tenderit, sepse:

- ka lejuar shkelje të rregullave në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, duke mos zbatuar detyrat e përcaktuara në Kreun V, pika 2, gërma “a” të VKM nr.1, date 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, shkelje e konstatuar në

tenderin me objekt “Shërbimi i ruajtjes së MMPAU-s”, me vlerë 2,021,000 lekë, zhvilluar më 15/2/2010.

7. ██████████ *me detyrë Shefe e Sektorit të Buxhetit*, për mosarkëtim e detyrimeve debitore në shumën prej 2,024,622 lekë, krijuar nga viti 2001, detyrë e lënë nga KLSH, rakordimet tremujore dhe vjetore me AUB për të gjithë detyrimet debitore në shumën 104,327,730 lekë, bazuar në VKM nr. 63, datë 26/1/2001 “Për procedurat e kërkit, të shqyrtimit dhe dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe konçesioneve për përdorim e rezervave ujore”, në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 1876, datë 29/4/2010 “ Për organizimin dhe funksionimin e MMPAU”, si dhe mosplanifikim të të ardhurave nga AUB.

8. ██████████ *me detyrë Drejtor i Politikave të Ujit pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave:*

- Për mos evidentimin dhe mos rakordimin si tremujor dhe vjetor me AUB të të gjitha detyrimeve debitore, bazuar në VKM nr.63, datë 26/1/2001 “Për procedurat e kërkit, të shqyrtimit dhe dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe konçesioneve për përdorim e rezervave ujore”, në Rregulloren e Brendshme të MMPAU nr. 1876, datë 29/4/2010 “Për organizimin dhe funksionimin e MMPAU”.

D.2 *Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr.7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe Kontratën individuale të punës”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

“ *Vërejtje me shkrim*”, për:

1. ██████████ *Inspektore në AUB Tiranë*, për mos kryerje të detyrës në dokumentimin dhe administrimin e aktivitetit ekonomik financiar për periudhën pas muajit maj 2011.

2. ██████████ *shofer, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave*, sepse, ka lejuar kualifikimin e ofertave në kushtet e mosplotësimit të dokumentacionit dhe kriterit teknik të kualifikimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 46, germa b të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 me ndryshimet, shkelje e konstatuar në tenderin me objekt “Blerje autoveturë e përdorur”, me fond limit rreth 2,375 mijë lekë, zhvilluar më 30/7/2010;

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bajram Lamaj Përgjegjës Grupi, Fadil Dekovi dhe Vjollca Selmani. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj.Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtorit të

Drejtorisë dhe me porosi), si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT